

EDICIONI  
I KATËRT

# *Lista e Kontrollit në fushën e sundimit të ligjit*

“Paparashikueshmëri në procedurat ligjbërëse”



GRUPI PËR STUDIME  
JURIDIKE DHE  
POLITIKE



Embassy of the  
Kingdom of the Netherlands

## Lista e Kontrollit në fushën e sundimit të ligjit

"Paparashikueshmëri në  
procedurat ligjbërëse"  
Edicioni i katërt

Nëntor 2022 – Prill 2023

© Grupi për Studime Juridike dhe Politike, prill 2023.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike

Rr. "Rexhep Luci", 16/1

Prishtinë 10 000, Kosovë

Ueb: [www.legalpoliticalstudies.org](http://www.legalpoliticalstudies.org)

E-mail: [office@legalpoliticalstudies.org](mailto:office@legalpoliticalstudies.org)

Tel/fax.: +381 38 234 456

Ky raport është publikuar në kuadër të projektit me titull:  
"Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të parimeve të sundimit të  
ligjit në Kosovë në bazë të listës së kontrollit të Këshillit të Evropës  
për Sundimin e Ligjit", që financohet nga Ambasada e Mbretërisë  
së Holandës në Kosovë, dhe implementohet nga Grupi për Studime  
Juridike dhe Politike.



GRUPI PËR STUDIME  
JURIDIKE DHE  
POLITIKE



Embassy of the  
Kingdom of the Netherlands

# *Përmbajtja*

<i>Përmbledhje ekzekutive</i>	4
<i>Hyrje</i>	5
<i>Metodologjia</i>	6
<i>Sundimi i ligjit në Kosovë – analizimi i të dhënave</i>	7
A. <i>Ligjshmëria</i>	7
B. <i>Siguria juridike</i>	11
C. <i>Parandalimi i abuzimit (keqpërdorimit) të pushtetit</i>	13
D. <i>Barazia para ligjit dhe mosdiskriminimi</i>	14
E. <i>Qasja në drejtësi</i>	15
<i>Përfundimet</i>	19

# Përmbledhje ekzekutive

Ky raport monitoron dhe vlerëson gjendjen e gjashtëmujorit të fundit të Sundimit të Ligjit në Kosovë, bazuar në Listën e Kontrollit të Sundimit të Ligjit, të krijuar dhe miratuar nga Komisioni i Venecias.<sup>1</sup> Kjo listë e kontrollit shërben si një mjet për vlerësimin sistematik dhe gjithëpërfshirës të shtyllave themelore në fushën e sundimit të ligjit. Raporti aktual i vlerësimit ofron informata të detajuara në lidhje me periudhën kohore nga muaji nëntor i vitit 2022 deri në prill të vitit 2023.

Nota mesatare e përmbushjes për këtë periudhë për Republikën e Kosovës është 51.76%, që do të thotë se Kosova ka shënuar përsëri një notë mbi “notën kaluese”, që nuk ka shumë dallim me vlerësimin për periudhën paraprake (maj-tetor 2022). Nga pesë (5) kategoritë e vlerësuara, kategoria Barazia para ligjit ka shënuar përsëri pikët më të larta, me një rezultat prej 70%, e cila mbeti me pikë të njëja sikur në vlerësimin e kaluar. Megjithatë, shqetësime janë ngritur për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara. Nga ana tjetër, kategoria Parandalimi i Abuzimit (Keqpërdorimit) të Pushtetit shënoi përsëri rezultatin më të ulët duke shënuar 37.5% përmbushje, pa pësuar ndryshim të pikëve nga vlerësimi i kaluar. Të gjitha kategoritë e tjera, Ligjshmëria (40%), Siguria Juridike (53.12%), Qasja në Drejtësi (58.2%) shënuan një rezultat mesatar, i cili është analizuar në këtë raport. Megjithatë, kategoria Ligjshmëria dhe Siguria Juridike ka pësuar një rënie të pikëve në krahasim me vitin e kaluar. Vlen të theksohet, që në krahasim me vlerësimin e kaluar nuk ka ndryshim të madh, megjithatë vlerësimi ka pësuar një rënie prej 1.48% të përmbushjes.

<sup>1</sup> Lista kontrolluese për sundimin e ligjit, miratuar nga Komisioni i Venecias në seancën e tij të 106-të plenare, Venedik, 11-12 mars 2016, i qasshëm në: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)007-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)007-e)

# Hyrje

Kosova përballet me sfida të ndryshme në sektorin e sundimit të ligjit, duke përfshirë reforma të shumta në drejtësi, të cilat sfidohen në Gjykatën Kushtetuese, e po ashtu zgjidhja e rasteve në gjykata në mënyrë shumë të ngadaltë. Ky vlerësim nuk paraqet ndonjë ndryshim nga vlerësimet e kaluara, nuk ka përmirësime evidente, madje na paraqitet një rënie e lehtë e rezultatit krahasuar me atë të periudhës paraprake. Sfida dhe probleme na paraqiten pothuajse në secilën prej shtyllave të kontrollit të sundimit të ligjit.

Në kategorinë e parë Ligjshmëria, e cila ka shënuar 40% të përmbushjes vërejmë se vazhdon të ketë vonesa në miratimin e ligjeve dhe akteve nënligjore. Për më tepër, nënkategoria procedurat ligjbërëse ka shënuar rënie në krahasim me periudhën e kaluar duke qenë se ka pasur miratim të ligjeve dhe akteve nënligjore pa i respektuar procedurat e përcaktuara ligjore, duke anashkaluar në tërësi procesin e konsultimit publik. Të gjitha aktet nënligjore që burojnë nga Ligji për Pagat në Sektorin Publik janë miratuar pa kaluar në procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, edhe në këtë periudhë është konstatuar se Kosova ka nevojë për reforma thelbësore në detyrën e zbatimit të ligjit, ku rezultati ishte më i ulët, për shkak se Kosova ka vështirësi në zbatimin e ligjit dhe mungojnë mjetet efektive që do të mundësonin zbatimin e ligjit në përpikmëri. Gjithashtu, në nënkategorinë për marrëdhëniet ndërmjet sistemit juridik vendas dhe ligjeve ndërkombëtare konstatohet se ka nevojë që t'i kushtohet rëndësi më të madhe dhe kujdes për shkak të miratimit të Ligjit për Zyrtarë Publikë në kundërshtim me nenin 120 i Ligjit për MSA-në duke evituar mundësinë që ligjet e reja të përfundojnë për vlerësim të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese.

Në kategorinë e Sigurisë juridike vërejmë se ligjet ndryshohen shumë shpesh, gjë që ndikon në stabilitetin dhe konsistencën e ligjeve, kjo për arsye se shpesh këto ndryshime ligjore nuk arrihen të arsyetohen dhe miratohen me një procedurë të përshpejtuar. Po ashtu, edhe në kategorinë e parandalimit të abuzimit (keqpërdorimit) të pushtetit kemi parë raste kur autoritetet publike kanë tejkaluar kompetencat e tyre apo kanë vepruar në kundërshtim me aktet juridike në fuqi. Gjithashtu, edhe te kategoria e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimi vërehet se ende paraqiten sfida, ku p.sh gratë shpesh diskriminohen e sidomos personat me aftësi të kufizuar. Sfida dhe probleme në kategorinë e qasjes në drejtësi paraqiten në të gjitha aspektet, përfshirë edhe në aspektin e efektivitetit të vendimeve gjyqësore, ku shpesh vërejmë mangësi në mbikëqyrjen e zbatimeve të vendimeve gjyqësore.

Vlen të theksohet se, gjatë periudhës së vlerësimit Gjykata Kushtetuese ka shpallur të pavlefshëm në tërësi Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Edhe pse Projektligji ishte dërguar dy herë në Komisionin e Venecias për vlerësim, Kuvendi i Kosovës nuk kishte arritur që të miratojë një ligj në këtë fushë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Disa aspekte të rekomandimeve të opinionit të Komisionit të Venecias për Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës nuk janë marrë parasysh dhe kështu të njëjtat të gjetura i ka pasur edhe Gjykata Kushtetuese. Gjithashtu, dy ligjet tjera tejet të rëndësishme për reformën në Administratën Publike kanë përfunduar në Gjykatën Kushtetuese, Ligji për Zyrtarët Publikë, i cili nuk ka arritur të dekretohet nga Presidentja dhe Ligji për Pagat në Sektorin Publikë, i cili së fundi është dërguar në Gjykatë nga Avokati i Popullit, për shkak të pranimit të ankesave të shumta.

# Metodologjia

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) bën monitorimin dhe vlerësimin e rregullt të zbatimit të sundimit të ligjit në Kosovë, bazuar në listën e kontrollit të Këshillit të Evropës për vlerësimin e sundimit të ligjit nga pikëpamja e dispozitave kushtetuese, ligjeve, akteve nënligjore si dhe rregullave të procedurës për të vlerësuar dallimin ndërmjet ligjit të shkruar dhe zbatimit të tij. Ky vlerësim bëhet në baza gjashtëmujore.

Lista e kontrollit përmban tetë standarde kryesore, të cilat nga ana e tyre përfshijnë disa tregues për të monitoruar dhe vlerësuar gjendjen aktuale. Kategoritë e përmendura më poshtë konsiderohen se parashikojnë konceptet thelbësore të përbashkëta të sundimit të ligjit. Kushtetuta u mor si burimi më i lartë i ligjit, i ndjekur nga legjislacioni parësor dhe sekondar, vendimet gjyqësore dhe raportet përkatëse të monitorimit të OSHC-ve.

Metodologjia e bazuar në listën kontrolluese ka 5 kategori:

1. Ligjshmëria (legaliteti);
2. Siguria juridike;
3. Parandalimi i abuzimit (keqpërdorimit) të pushtetit;
4. Barazia para ligjit dhe mosdiskriminimi;
5. Qasja në drejtësi.

Treguesit brenda secilit grup përfshijnë më tej pyetje që duhet të plotësohen në mënyrë që treguesi të realizohet plotësisht. Çdo pyetje operative caktohet me një pikë 1 nëse pyetja operative është përmbushur, 0 nëse jo dhe, në rastet kur situata është e dyshimtë, jepet 0,5. Përmbushja e treguesve jep përqindjen e përmbushjes - për shembull nëse një tregues ka 6 pyetje operative dhe 3 janë arritur, atëherë mund të themi se treguesi është përmbushur 50%. Për më tepër, analiza jep edhe një interpretim përshkrues dhe shpjegim të rezultateve.

# *Sundimi i ligjit në Kosovë – analizimi i të dhënave*

## **A. LIGJSHMËRIA**

Parimi i ligjshmërisë përcakton bazën e secilit shtet demokratik dhe funksional. Përfshinë supremacinë e ligjit ku veprimet e shtetit duhet të jenë në përputhje dhe të autorizuara me ligj. Ky parim është i përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës të vitit 2008. Përkufizimi kushtetues i këtij parimi është më i ngushtë, sepse i referohet ligjshmërisë dhe proporcionalitetit në rastet penale. Megjithatë, përcaktimet tjera të të kodifikuara në Kushtetutë ofrojnë një dëshmi formale për ekzistencën e supremacisë së ligjit.<sup>2</sup>

Parimi i ligjshmërisë përfshin Supremacinë e Ligjit, Marrëdhëniet ndërmjet së të Drejtës Ndërkombëtare dhe të Drejtës Vendore, Kompetencat Ligjbërëse të Ekzekutivit, Procedurat Ligjbërëse, Përjashtimet në Situatat Emergjente, Detyrën për Zbatimin e Ligjit, Aktorët Privatë në krye të Detyrave Publike.

Supremacia e Ligjit nga gjithsej 8 pikë shënoi 3 pikë. Kjo nën-kategori shtjellon përputhshmërinë e veprimeve të shtetit me autorizimet kushtetuese dhe ligjore. Pra, e analizon përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën, si dhe procesin e miratimit të ligjeve kur kërkohet nga Kushtetuta dhe miratimin e akteve nënligjore kur kërkohet nga ligjet brenda kohës së përcaktuar me atë ligj.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës njih këtë nënkategori, për arsye se përcakton se Kushtetuta është akti më i lartë juridik dhe se ligjet dhe aktet tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë.<sup>3</sup> Përputhshmëria e legjislacionit me Kushtetutën e Republikës së Kosovës është përgjegjësi e institucioneve që ta sigurojnë atë, si në fazë të draftimit, në fazë të miratimit dhe po ashtu në disa raste edhe pas miratimit të tij. Supremacia e Ligjit trajton faktin se a bëhet miratimi i ligjeve pa vonesa.

Legjislacioni vazhdon të miratohet me vonesë, edhe pse për dallim nga vlerësimi i kaluar, Ligji për Pagat dhe Ligji për Zyrtarët Publikë janë miratuar. Gjykata Kushtetuese ka obliguar Kuvendin e Kosovës që t'i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të ndryshuar këto ligje në përputhje me të gjeturat e Gjykatës Kushtetuese. Pavarësisht faktit se këto ligje janë miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës nuk mund të themi se të gjeturat e Gjykatës janë zbatuar në këto dy ligje dhe kjo vërtetohet se të dyja këto ligje përsëri janë në gjykatë për vlerësim të kushtetueshmërisë. Ligji për Zyrtarët Publikë, në momentin e këtij vlerësimi është duke u shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese për përputhshmërinë e tij me Kushtetutën. Pra, i njëjti nuk ka arritur të dekretohet nga Presidentja e Republikës së Kosovës për arsye se është dërguar në Gjykatë për vlerësim. Gjithashtu, edhe për Ligjin për Pagat në Sektorin

2 Qerimi, Qerim. "Operacionalizimi dhe matja e sundimit të ligjit në një kontekst tranzicional të ndërkombëtarizuar: Lista kontrolluese e Komisionit të Venecias për Sundimin e Ligjit", "Law and Development Review 13", no. 1 (2020): 59-94. <https://doi.org/10.1515/ldr-2019-0010>.

3 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 16.



Publik janë dërguar 104 ankesa te Avokati i Popullit.<sup>4</sup> Nga kjo rrjedhë që është shkaktuar vonesë dhe nuk është arritur që me kohë të jetësohen këto ligje. Vonesat në miratimin e ligjeve mund t'i vërejmë edhe nga Programi Legjislativ për vitin 2020, ku nga 172 projektligje të parapara janë miratuar vetëm 72 projektligje në Qeveri.<sup>5</sup>

Miratimi i akteve nënligjore që burojnë nga Ligji nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura vazhdojnë të jenë në vonesë. Nga periudha e kaluar janë miratuar edhe katër (4) Rregullore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës (Rregullorja për Institutin e Kosovës për Administratë Publike, për Ministrinë e Ekonomisë, për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës dhe për Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve). Pra, në këtë drejtim, Rregullorja (QRK) Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura (në tekstin në vijim: Rregullorja (QRK) Nr. 01/2020) përcakton afat kohor brenda të cilit duhet të hartohen rregulloret përkatëse për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës, duke caktuar se këto rregullore duhet të hartohen brenda afatit kohor prej gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e Rregullores (QRK) Nr. 01/2020, si dhe të paraqiten për miratim, që do të thotë se Institucionet e Administratës Shtetërore janë në vonesë.

Nënkategoria Supremacia e Ligjit gjithashtu vlerëson faktin se sa ekzekutivi ndërmerr veprime në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjin. Në këtë drejtim kjo pikë vlerësuese ka shënuar rënie, sepse në disa raste Gjykata ka vlerësuar se Ligjet e miratuara nga Kuvendi dhe të propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Së fundi, Gjykata Kushtetuese ka njoftuar për vendosjen në rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Në këtë rast Gjykata ka shpallur këtë Ligj në kundërshtim me Kushtetutën dhe ka shpallur të pavlefshëm tërësinë e tij.<sup>6</sup>

Pajtueshmëria me ligjin shënoi 2.5 nga 6 pikë mbeti e pa ndryshuar nga vlerësimi i kaluar. Kjo nënkategori trajton se a janë autorizimet e autoriteteve të përcaktuara me ligj, se a janë veprimet e tyre në përputhje me ligjin, nëse kompetencat e autoriteteve publike janë të ndara qartazi, se a mund të veprojnë autoritetet publike pa bazë ligjore dhe nëse po a arsyetohen këto veprime. Dispozitat kushtetuese dhe legjislativo ofrojnë përkufizim të qartë të kompetencave, mirëpo shpesh autoritetet publike dështojnë në respektimin e rregullativës në fuqi. Vlerësimi i akteve nënligjore të miratuara nga Qeveria e Kosovës është bërë në nëntor të vitit 2022, ngjashëm me vlerësimin që është bërë për aktet nënligjore të nxjerra nga ministritë, ku është gjetur se nga totali 1762 akte, 289 kanë qenë pa bazë ligjore që nga themelimi deri në vitin 2021.<sup>7</sup> Ky është një aspekt pozitiv për arsye se janë shfuqizuar 25 akte nënligjore të Qeverisë përmes Vendimit nr. 10/109 të datës 23 nëntor 2022.<sup>8</sup> Me këtë Vendim është miratuar analiza juridike për vlerësimin e bazës ligjore të akteve nënligjore të nxjerra nga Qeveria. Ky Vendim është ndryshuar dy herë, me Vendimin e Qeverisë nr. 03/111 të datës 7 dhjetor 2022 dhe me Vendimin nr. 02/137 të datës 31 mars 2023.<sup>9</sup> Me këto dy vendime janë ndryshuar disa akte që fillimisht janë përfshirë në listën e shfuqizimit. Për më tepër, mungon harmonizimi i ligjeve të veçanta me ligje horizontale, gjë që cenon interesat e ligjshme dhe të drejtat e personave, si p.sh. ende nuk janë harmonizuar ligjet e veçanta me Ligjin për Inspektimet, Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Ligjin për Sistemin e Lejeve dhe Licencave.

4 Komunikatë për media – Avokati i Popullit dërgoi në Gjykatën Kushtetuese Ligjin nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë së tij me Kushtetutën, <https://oik-rks.org/2023/04/07/komunikate-per-media-avokati-i-popullit-dergoi-ne-gjykatën-kushtetuese-ligjin-nr-08l-196-per-pagat-ne-sektorin-publik-me-kerkesë-per-vlerësimin-e-perputhshmerise-se-tij-me-kushtetuten/>

5 Programi Legjislativ për Vitin 2020, <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/programi-legjislativ-per-vitin-2022-3/>

6 Njoftimi i Gjykatës Kushtetuese për vendosjen në rastin KO 100/22 dhe KO 101/22, <https://gjk-ks.org/njoftim-per-vendim-ne-rastin-ki-100-22-dhe-ki-101-22/>.

7 Vendimi i Qeverisë nr. 02/50, i datës 23 dhjetor 2021 për miratimin e analizës juridike për vlerësimin e bazës ligjore të akteve nënligjore të nxjerra nga ministrat;

8 Vendimi i Qeverisë nr. 10/109 të datës 23.11.2022 për miratimin e analizës juridike për vlerësimin e bazës ligjore të akteve nënligjore të nxjerra nga Qeveria, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=66799>.

9 Vendimi nr. 03/111 i datës 7 dhjetor 2022, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=67106>

Vendimi nr. 02/137 i datës 31 mars 2023, <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/03/Vendimet-e-mbledhjes-se-137-te-Qeverise.pdf>



Sa i përket marrëdhënies ndërmjet të së drejtë ndërkombëtare dhe të drejtës vendore, shënoi 1 pikë nga 2 pikë gjithsej. Kjo nënkategori trajton se a siguron legjislacioni vendor që shteti t'ju përmbahet rregullave të ligjit ndërkombëtar. Edhe pse Kosova nuk është pjesë e shumë marrëveshjeve ndërkombëtare apo regjionale dhe konventave për të drejtat e njeriut, neni 22 i Kushtetutës të Republikës së Kosovës përcakton marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut, të cilat zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës, si dhe prioritetit të cilin ato gëzojnë.<sup>10</sup> Mirëpo, Ligji për Zyrarë Publikë i miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më 22 dhjetor 2022,<sup>11</sup> bie në kundërshtim me nenin 120 të Ligjit nr. 05/L-069 për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër (në tekstin në vijim: Ligji për MSA-në). Ky nen përcakton se bashkëpunimi në fushën e Administratës Publike, ndër të tjera do të përqëndrohet në zhvillimin e karrierës në shërbimin publik, e që në këtë ligj nuk është reflektura por përkundrazi me qëllim është rrënuar sistemi i karrierës. Por, Ligji nuk ka arritur të hyjë në fuqi, të dekretohet, për arsye se është dërguar në Gjykatë Kushtetuese për vlerësim të kushtetutshmërisë. Sa i përket zbatimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut në vendimet e Gjykatat e rregullta ende nuk i zbatojnë ato në numër të kënaqshëm.

Kompetencat Ligjbërëse të Ekzekutivit ka shënuar 1 pikë nga 3. Kjo nënkategori trajton supremacinë e legjislativit, nëse rregullat e përgjithshme janë të përfshira në një akt të Parlamentit, nëse parashihen mjete efektive kundër abuzimit dhe delegimi i autorizimeve të legjislativit nga Parlamenti në ekzekutiv. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 4, paragrafi 4 përcakton se: "Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar."<sup>12</sup> Kontrolli parlamentar rregullohet më hollësisht përmes Rregullores së Punës së Kuvendit, e cila ka bazë në nenin 76 të Kushtetutës. Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës ka hyrë në fuqi në korrik 2022.<sup>13</sup> Sipas Rregullores në fjalë, Komisioni parlamentar mund të organizojë seanca dëgjimore me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve dhe politikave. Megjithatë, këto seanca dëgjimore mbahen shumë rrallë apo fare. Më 22 shkurt 2023, Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në mbledhje të rregullt formoi grupin punues për monitorimin e Ligjit 04/L-156 për kontrollin e duhanit, si dhe Ligjit 08/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-156 për kontrollin e duhanit.<sup>14</sup> Në këtë mbledhje u tha se varësisht nga të gjeturat e Grupit Punues do të rekomandohet se si të ri-jetësohet ky Ligj. Pas formimit të këtij Grupi Punues, Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural doli me njoftimin se nuk do të ketë më tolerancë për moszbatimin e Ligjit në fjalë<sup>15</sup> dhe për më pak se një javë u shqiptuan rreth 150 gjoba për shkelësit e ligjit të duhanit.<sup>16</sup> Gjithashtu, Komisioni për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Viktima të Dhunës Seksuale të Luftës, për Persona të Pagjetur dhe Peticione ka diskutuar lidhur me çështjen e moszbatimit të Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.<sup>17</sup> Pra, kompetenca e Kuvendit për mbikëqyrje shumë rrallë shfrytëzohet.

Nënkategoria Procedurat ligjbërëse e cila trajton faktin se sa janë procedurat transparente, gjithëpërfshirëse dhe demokratike ka shënuar një rënie në krahasim me vlerësimin e kaluar. Kjo nënkategori shënoi 3 pikë nga 6. Kushtetuta përcakton procedurat ligjbërëse duke përcaktuar Kuvendin si organ suprem për vendosjen e përmbajtjes së ligjit, llogaridhënies, transparencës dhe gjithëpërfshirjes. Rregullorja (QRK) nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik<sup>18</sup> përcakton qartazi rregullat e konsultimit. Kjo rregullore në periudhën për të cilën është duke u bërë vlerësimi nuk është respektuar. Në Qeveri janë miratuar 11 akte nënligjore, të cilat burojnë nga

10 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

11 Vendimi për miratimin e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë, [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/197Vendim\\_FwdaubfBxV.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/197Vendim_FwdaubfBxV.pdf)

12 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 4, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

13 Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61266>

14 Lajm nga mbledhja e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-shendetesi-dhe-31937/>.

15 Peci kërkon zbatimin e Ligjit të 2013-s: Zero tolerancë ndaj duhanit në ambiente të mbyllura, <https://www.koha.net/arberi/369921/peci-kerkon-zbatimin-e-ligjit-te-2013-s-zero-tolerance-ndaj-duhanit-ne-ambiente-te-mbyllura/>

16 Rreth 150 gjoba për shkelësit e ligjit të duhanit, <https://kosovapress.com/rreth-150-gjoba-per-shkelësit-e-ligjit-te-duhanit/>

17 Nga seanca e Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/lajmi/nga-seanca-e-komisionit-per-te-drejta-te-njer-31850/>

18 Rregullore (QRK) nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15036>

Ligji për Pagat pa kaluar fare nëpër procedurat e përcaktuara. Për më tepër edhe miratimi i ligjeve është bërë pa i ndjekur procedurat e përcaktuara ligjore. Si p.sh. Projektligji për Investime të Qëndrueshme i miratuar në mbledhjen e 118 të Qeverisë së Kosovës, me vendimin nr. 02/118, datë 11 janar 2023,<sup>19</sup> i cili nuk i ka ndjekur procedurat e përcaktuara ligjore të konsultimit publik. Gjithashtu edhe koeficienti i pagës së zyrtarëve publikë nuk ka qenë i ditur deri në miratimin e Ligjit nr. 08/L-213 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i cili është publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 28 shkurt 2023.<sup>20</sup> Pra, ky është një regres pasi që në këto raste procedurat e konsultimit publik nuk janë respektuar fare. Për më tepër, ka raste kur komentet nuk merren parasysh dhe nuk publikohet apo arsyetohet një gjë e tillë. Një gjë e tillë është thënë edhe nga përfaqësuesi i BE-së, i cili ka deklaruar se komentet e Zyrës së BE-së në lidhje me Ligjin për Paga dhe Ligjin për Zyrtarë Publikë nuk janë marrë parasysh dhe se këto ligje janë bërë në procedurë të shpejtë pa u konsultuar me palët e interesit.<sup>21</sup>

Në platformën e konsultimeve publike figuron se për datat 1 nëntor 2022 deri 7 prill 2023, vetëm 45.1% e konsultave publike kanë të publikuar raportet finale nga institucionet qendrore.<sup>22</sup> Marrë parasysh se këto raporte shpesh kanë të dhëna vetëm sipërfaqësore dhe në realitet nuk pasqyrojnë se si janë adresuar komentet e pranuar nga palët e interesit. Sipas platformës, vlerësohet se për këtë periudhë janë pranuar 0 komente.<sup>23</sup> Ky numër nuk është real, mirëpo për shkak që të dhënat nuk vendosen në mënyrë të duhur atëherë e kemi këtë pasqyrim.

Po ashtu, edhe pse Kuvendi debaton publikisht për legjislacionin e propozuar, mungojnë raportet shpjeguese për publikun. Platforma e Kuvendit është informuese për publikun për sa i përket fazës në të cilën ndodhet një projektligj, mirëpo nuk ka raporte shpjeguese.<sup>24</sup>

Për vitin 2023, janë planifikuar që të bëhen 33 analiza ex-ante të legjislacionit (koncept dokumente), sipas Listës së nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit.<sup>25</sup> Nga janari i vitit 2023 Qeveria miratoi pesë (5) Koncept Dokumente në fusha të ndryshme, si Koncept Dokumenti në fushën e Automjeteve, Falimentimit, për Fondin e Konfiskimit, për organizimin e tregut të përbashkët të produkteve bujqësore dhe për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës. Sa i përket vlerësimeve ex-post të legjislacionit, për vitin 2023 janë planifikuar të hartohen 7 Raporte të Vlerësimit Ex-Post të Legjislacionit dhe deri tash janë aprovuar 4 Vlerësime Ex-post (Vlerësimi për Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, për Ligjin për Avokatinë, për Ligjin nr. 06/L-026 për Azil dhe për Ligjin nr.04/L-147/2023 për Planifikim Hapësinor).<sup>26</sup> Megjithatë, nuk ka ndonjë mekanizëm përcjellës që do të tregonte se si zbatohen të gjeturat e vlerësimeve ex-post dhe as se si të gjeturat e këtyre raporteve përfshihen në koncept dokumen, të cilat zakonisht i paraprijnë procesit të hartimit të legjislacionit.

Nënkategoria Përrjashtimet në situatat emergjente shënoi 3 pikë nga totali prej 4 pikëve. Kjo nënkategori trajton faktin se përrjashtimet në situata emergjente a përcaktohen me ligj. Neni 131 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton saktë se cilat dispozita vlejnë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, fushëveprimi, kohëzgjatja dhe kufizimet. Po ashtu, përcaktohet se cilat ligje nuk mund të ndryshohen gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, ligji për zgjedhjet e Kuvendit dhe të Komunave, si dhe përcaktohet se parimet e tjera për veprimet e institucioneve publike gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme rregullohen me ligj por çdo herë në përputhje me nenin specifik të Kushtetutës. Kjo nënkategori mbetet e pandryshuar nga periudha e kaluar e vlerësimit.

Nënkategoria e Detyrës për Zbatimin e Ligjit nga autoritetet publike shënoi 0 pikë nga 5 gjithsej. Kjo për arsye se kjo nënkategori analizon se cilat masa ndërmerren për të siguruar që autoritetet publike të zbatojnë ligjet në mënyrë efektive, duke u fokusuar në pyetjet se a ka vështirësi në zbatimin e ligjit, se a ka mjete efektive

19 Projektligj për Investime të Qëndrueshme,

<https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/01/Projektligj-per-Investime-te-Qendrueshme.pdf>

20 Ligji nr. 08/L-213 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=68589>

21 Klan Kosova, Szunog: Reforma në Administratën Publike, çelës për anëtarësimin në BE,

<https://klankosova.tv/szunog-reforma-ne-administraten-publike-celes-per-anetaresim-ne-be/>

22 Përmbledhje e llojeve të publikuara sipas publikimit të reputeve finale – data 01.11.2022-07.04.2023, <https://konsultimet.rks-gov.net/statistics.php>, qasur më 7 prill 2023.

23 Platforma e konsultimeve publike, qasur më 7 prill 2023, <https://konsultimet.rks-gov.net/statistics.php>

24 Platforma e Kuvendit të Republikës së Kosovës, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet-dhe-ligjet/>

25 Lista e Koncept Dokumenteve për vitin 2023, <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/lista-e-koncept-dokumente-2023/>

26 Dokument i pranuar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike të paraqitur në Zyrën e Kryeministrit më datë 12 prill 2023;

kundër mos-zbatimimit të ligjit, se a janë të specifikuar në mënyrë të qartë sanksionet për mos-zbatimin e ligjit dhe nëse po se si zbatohet ky sistem. Në Kosovë, institucionet publike janë të prirura të miratojnë ligje në përputhje me kornizën ligjore të BE-së, pa kryer analizë ex-ante në mënyrë të duhur për të përshtatur në mënyrë sa më të mirë me shtetin përkatës. Për më tepër, nuk ka mjete juridike efektive që sigurojnë zbatimin efektiv të ligjit nga autoritetet publike dhe nuk ka masa specifike të përcaktuara në rast të moszbatimit të Ligjit. Gjithashtu, duhet të theksojmë se institucionet publike vazhdojnë të dështojnë në vlerësimin e ndikimit të ligjit, si në vlerësimin paraprak e ashtu edhe në atë ex-post e po ashtu në zbatimin e ligjit. Së fundi, në mars 2023 ka filluar të zbatohet Ligji nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, përmes paralajmërimit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zero tolerancë: "Nga sot zero tolerancë ndaj duhanit në ambiente të mbyllura".<sup>27</sup> Pra, përmes aktivizimit të ministrisë dhe shqiptimit të disa gjobave ky ligj ka filluar që të respektohet në masë të madhe edhe nga qytetaret dhe bizneset. Por, ky ligj ka hy në fuqi në vitin 2013<sup>28</sup> dhe zbatimi i ligjeve duhet të sigurohet që të bëhet që nga fillimi e po ashtu që të ketë një konsistencë dhe jo që një ligj të zbatohet kohë pas kohe.

Ndërsa sa i përket nënkategorisë Aktorët privatë të ngarkuar me detyra publike, Kushtetuta e Kosovës nuk parasheh dispozita për delegim të detyrave publike te aktorët privatë. Megjithatë, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA) zbatohet sa herë që një person privat vepron në emër të një instituti publik me një autorizim të qartë me ligj ose në bazë të një ligji, gjë që specifikohet qartë në nenin 2, paragrafi 2 i këtij ligji. E po ashtu edhe Ligji për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura (LOFAShAP), në nenin 33 përcakton se: "Administrata shtetërore mund të delegojë ushtrimin e detyrave të caktuara për realizimin e funksioneve administrative sipas këtij ligji, personave fizikë apo juridikë fitimprurës dhe jofitimprurës." E po ashtu, ky ligj në nenin 34 dhe 35 përcakton kushtet e delegimit dhe mbikëqyrjes së detyrave të deleguara. Kjo nënkategori shënoi 0.5 nga 1 pikë, pasi edhe pse LPPA zbatohet për raste të tilla kur një detyrë publike u transferohet subjekteve joshtetërore, mungon mbikëqyrja efektive e zbatimit të detyrave të deleguara.

Kategoria e Ligjshmërisë shënoi 40% të përmbushjes (14 pikë nga gjithsej 35) për periudhën nëntor 2022 – prill 2023. Nënkategoria procedurat ligjëbërëse ka shënuar rënie në krahasim me periudhën e kaluar duke qenë se ka pasur miratim të ligjeve dhe akteve nënligjore pa i respektuar procedurat e përcaktuara ligjore, duke anashkaluar në tërësi procesin e konsultimit publik. Edhe në këtë periudhë konstatohet se Kosova ka nevojë për reforma thelbësore në detyrën e zbatimit të ligjit, ku rezultati ishte më i ulët, për shkak se Kosova ka vështirësi në zbatimin e ligjit dhe mungojnë mjetet efektive që do të mundësonin zbatimin e ligjit në përpikmëri. Gjithashtu, në nënkategorinë për marrëdhëniet ndërmjet sistemit juridik vendas dhe ligjeve ndërkombëtare konstatohet se ka nevojë që t'i kushtohet rëndësi më të madhe dhe kujdes për shkak të miratimit të Ligjit për Zyrtarë Publikë në kundërshtim me nenin 120 i Ligjit për MSA-në duke evituar mundësinë që ligjet e reja të përfundojnë për vlerësim të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese.

## B. SIGURIA JURIDIKE

Kategoria e dytë e listës kontrolluese për sundimin e ligjit është Siguria juridike. Kjo kategori ka të bëjë me parimin se ligji duhet të jetë i qartë, i parashikueshëm dhe i qasshëm për secilin. Do të thotë që secili individ duhet të jetë në gjendje të kuptojë se çka kërkohet nga ligji dhe si aplikohet në situata të caktuara. Pra, promovon stabilitet, konsistencë dhe drejtësi në sistemin e drejtësisë. Kjo kategori përbëhet nga nënkategoritë në vijim: Qasja në legjislacion, Qasja në vendimet e gjykatave, Parashikueshmëria e ligjeve, Stabiliteti dhe konsistenca e ligjit, Pritjet legjitime, Jo retroaktiviteti, parimet Nullum Crimen Sine Lege dhe Nulla Poena sine Lege si dhe Res Judicata.

Nënkategoria Qasja në legjislacion shënoi 2 pikë nga gjithsej 2 pikë (100%), që do të thotë se nuk ka pasur ndryshime nga vlerësimet e kaluara. Kjo nënkategori trajton faktin se a janë të qasshme ligjet, se a publikohen të gjitha aktet ligjore para hyrjes në fuqi dhe se a janë të qasshme përmes internetit pa pagesë. Para hyrjes në fuqi të akteve ligjore qytetari ka mundësi që të qaset në ato duke pasur parasysh se projektligjet publikohen në faqen zyrtare të Zyrës së Kryeministrit pas miratimit nga Qeveria.

<sup>27</sup> Ministri Peci paralajmëron masa: Nga sot zero tolerancë ndaj duhanit në ambiente të mbyllura,

<https://zeri.info/aktuale/484998/ministri-peci-paralajmëron-masa-nga-sot-zero-tolerance-ndaj-duhanit-ne-ambiente-te-mbyllura/>

<sup>28</sup> Ligji nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8665>

Gjithashtu, projektligjet publikohen në faqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës, ku qytetarët kanë qasje dhe mund të shohin se në cilën fazë është projektligji i caktuar. Pas miratimit Ligjet publikohen në faqen zyrtare të Gazetës Zyrtare, ku janë të qasshme për të gjithë në pesë gjuhë: në gjuhën shqipe, angleze, serbe, turke dhe boshnjake. Te aktet nënligjore nuk është e njëjta situatë, ku edhe pse ato publikohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, mirëpo sidomos aktet nënligjore të nxjerra nga ministritë publikohen në format të papërshtatshëm (pdf i skenuar si fotografi), gjë që e bënë të vështirë përpunimin e tyre dhe kërkimin e informacioneve.

Nënkategoria Qasja në vendimet e gjykatave shënoi 1.5 pikë nga gjithsej 2 pikë. Vërehet se vazhdimisht është duke punuar në qasje më të lehtë të publikut në vendimet e Gjykatës. Po ashtu, vlen të theksohet se vendimet e Gjykatës Kushtetuese publikohen çdo herë brenda afatit të arsyeshëm kohor, në ueb faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese, por gjithashtu edhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim, Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2019 për publikimin e aktgjykimeve të përpunuara përcakton që të gjitha gjykatat t'i publikojnë të gjitha aktgjykimet, përveç disa përjashtimeve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit. Shumica e vendimeve të gjykatave themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, vazhdojnë të jenë të qasshme në uebfaqet e tyre përkatëse. Në dhjetor të vitit 2022 ky udhëzim administrativ është ndryshuar dhe plotësuar përmes Udhëzimit Administrativ nr. 01/2022, me të cilin përfshihet edhe rregullimi i publikimit të aktvendimeve të Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit dhe Dhomave të shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale, si dhe publikimit të aktvendimeve meritore të Dhomave të shkallës së parë të Gjykatës Komerciale dhe Gjykatave themelore të Republikës së Kosovës.<sup>29</sup> Megjithatë, rastet e përjashtimeve shpesh nuk arsyetohen për publikun. Deri më tani në ueb faqen e KGJK-së janë publikuar gjithsej 98967 aktgjykime të gjykatave të rregullta.<sup>30</sup>

Sa i përket nënkategorisë Parashikueshmërisë së ligjeve, shënoi 1 pikë nga gjithsej 2 pikë që do të thotë se nuk ka pasur ndryshim nga vlerësimi i kaluar. Kjo nënkategori trajton nëse ligjen shkruhen në formë të qartë dhe se nëse ligjet e reja përcaktojnë saktë se cilat ligje shfuqizohen apo ndryshohen dhe nëse ndryshimet përfshihen në një verzion të konsoliduar. Për më tepër, vlen të theksohet se periudha e hyrjes në fuqi është shumë e shkurtër. Si p.sh. në rastin e Ligjit për pagat në sektorin publik një muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare, ku kjo nuk ka qenë periudhë e mjaftueshme as për institucionet publike, dëshmuar nga fakti se nuk kanë arritur t'i procesojnë shtesat e zyrtarëve publikë. Në këtë drejtim, ligjet deri diku shkruhen në mënyrë të kuptueshme dhe të qartë, si dhe ligjet në mënyrë të shprehur përcaktojnë se cili ligj paraprak shfuqizohet apo ndryshohet. Mirëpo, këto ndryshime nuk përfshihen në një version të konsoliduar. Deri më tani, nuk kemi versione të ligjeve të konsoliduara që do t'i përfshinte të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e një ligji specifik. Kjo është një gjë negative, pasi ligjet në Kosovë ndryshohen shpesh dhe nuk është aspak praktike për qytetarin që t'i shfletojë të gjitha plotësim ndryshimet dhe t'i krahasojë ato, e po ashtu paraqet problem edhe për zyrtarët të cilët punojnë me ato ligje. Në këtë drejtim, ka pasur hapa që kjo çështje të rregullohet. Është hartuar Projektligji për aktet juridike, i cili përcakton që të rregullojë çështjen e konsolidimit të aktit juridik, ku organi propozues obligohet ta kryejë procedurën e konsolidimit. Më tutje, kjo çështje do të rregullohet me një akt nënligjor – udhëzimin administrativ për rregullimin e detajuar të kësaj procedure në harmoni me ligjin. Ky projektligj është ende në Kuvend, edhe pse në korrik 2022 është shqyrtuar nga Komisioni funksional në parim, i cili ka konstatuar se Projektligji i plotëson kushtet që t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në parim.<sup>31</sup> Do të ishte një gjë pozitive nëse do të rregullohet çështja e konsolidimit të ligjeve, për arsye se do ta lehtësonte qasjen dhe punën me këto ligje.

Nënkategoria Stabiliteti dhe konsistenca e ligjeve, shënoi 0.5 pikë nga gjithsej 2 pikë. Kjo nënkategori vlerëson se a janë ligjet stabile në atë masë që ndryshohen vetëm me paralajmërim të arsyeshëm dhe se a zbatohen në mënyrë konsistente. Në këtë drejtim vlen të theksohet se ligjet ndryshohen shumë shpesh dhe jo çdo herë paralajmërohet në mënyrë të arsyeshme.

29 Udhëzim Administrativ nr. 01/2022 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ nr. 01/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrativ 04/2019 për publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara, <https://www.gjyqesori-rks.org/udhezimet-administrative/?r=M&legId=288>

30 <https://www.gjyqesori-rks.org/aktgjykimet/>

31 Projektligji për Aktet Juridike, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=345>

Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi në parim Projektligjin nr. 08/L-180 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil<sup>32</sup>, i cili u miratua në mbledhje të Qeverisë me shpejtësi pa paralajmërim paraprak. Ky Projektligj nuk ka qenë i planifikuar të ndryshohet në fillim të vitit 2022. Ky propozim është përfshirë në programin legjislativ me vendimin nr. 06/78, të datës 16 maj 2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2022.<sup>33</sup> Ky Projektligj është publikuar në platformën e konsultimeve publike më datën 14 korrik 2022 me gjithsej 4 nene.<sup>34</sup> Ndërsa, më datë 30 shtator 2022 ky Projektligj është miratuar në Qeveri me vendimin nr. 30/99 me gjithsej 9 nene.<sup>35</sup> Pra, jo të gjitha plotësim ndryshimet kanë qenë të qasshme për publikun për komentim dhe ky Projektligj në tërësi është publikuar vetëm pas miratimit në Qeveri. Gjithashtu edhe Ligji i ri për Zyrarët Publikë, i miratuar në Kuvend më 22 dhjetor 2022,<sup>36</sup> është hartuar pa një analizë paraprake dhe dokument politikash për të analizuar se cilat janë opsionet më të mira për një rregullim ligjor. Ky ligj parasheh që të bëhet një ndryshim i tërësishëm në procedurën e rekrutimit edhe pse rekomandim i Gjykatës Kushtetuese ka qenë që të ndryshohet vetëm për t'i përfshirë gjetjet e Gjykatës Kushtetuese dhe kthimin nga një sistem i karrierës në atë të pozitës. Ky ligj i ri nuk ka arritur të dekretohet nga Presidentja për arsye se është dërguar në Gjykatë Kushtetuese për vlerësim të kushtetutshmërisë.<sup>37</sup>

Në anën tjetër, Projektligji për Këshillin Prokurorial është miratuar në lexim të dytë dhe dërguar në Gjykatë Kushtetuese për vlerësim. Më 5 prill 2023 Gjykata Kushtetuese nxjerr Aktgjykimin në rastet nr. KO100/22 dhe KO101/22 për Vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-136 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës,<sup>38</sup> me të cilin Gjykata shpall të pavlefshëm këtë ligj në tërësinë e tij. Pra, dy ndryshimet kryesore të përcaktuara me Projektligjin e ri të miratuar në lexim të dytë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës janë zvogëlimi i numrit të anëtarëve të Këshillit dhe zëvendësimi i menjëhershëm i anëtarëve aktual.<sup>39</sup> Këto çështje kanë ngritur debat publik e po ashtu këto ndryshime janë trajtuar edhe nga Komisioni i Venecias, i cili ka lëshuar dy opinione, ku opinioni i fundit është i datës 23 mars 2022 që ka trajtuar ndryshimet e bëra në Projektligjin në fjalë. Për sa i përket dispozitave kalimtare, Opinioni i Komisionit të Venecias ka theksuar se në draftin origjinal është propozuar që mandati i anëtarëve të Këshillit Prokurorial të përfundohet menjëherë, ku për këtë rast Komisioni i Venecias kishte thënë se të paktën disa nga anëtarët aktual duhet të lejohen që të vazhdojnë mandatin e tyre, përveç nëse parashikohet një përmirësim i madh në sistemin aktual. Në draftin e rishikuar kjo ide është braktisur dhe është propozuar që anëtarët aktual ta përfundojnë mandatin e tyre, pra të mos ndërprehet mandati i tyre menjëherë. Komisioni i Venecias ka theksuar se me versionin e rishikuar të dispozitave kalimtare respektohet siguria e mandatit të anëtarëve.<sup>40</sup> Përkundër këtij opinioni, Projektligji në Kuvend pësoi ndryshime dhe nga dispozitat kalimtare u largua dispozita që ofronte mundësinë e qëndrimit në detyrë të anëtarëve aktual të Këshillit Prokurorial deri në mbarim të mandatit aktual.

Po ashtu, Projektligji për Investime të Qëndrueshme është miratuar në mbledhjen e 118 të Qeverisë së Kosovës, me vendimin nr. 02/118, datë 11 janar 2023<sup>41</sup> pa kaluar nëpër konsultime publike. Vlen të theksohet se Zyrarët Publikë nuk kanë qenë të njoftuar për pagën e tyre deri në moment të fundit.

32 Vendimi për miratimin në parim të Projektligjit nr. 08/L-180 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/180Vendimpermiratimneparim\\_HuCF9kdGj2.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/180Vendimpermiratimneparim_HuCF9kdGj2.pdf)

33 Vendimi i Qeverisë, nr. 06/78, i datës 16 maj 2022 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=58974>

34 Projektligji për ndryshimin e Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil i publikuar në platformën e konsultimeve publike, <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41464>

35 Projektligji për ndryshimin e Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil i miratuar me Vendimin e Qeverisë nr. 30/99, të datës 30 shtator 2022, <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/10/PROJEKTLIGJI-PER-PLOTESIMIN-DHE-NDRYSHIMIN-E-LIGJIT-NR.-06L-048-PER-KESHILLIN-E-PAVARUR-MBIKEQYRES-PER-SHERBIMIN-CIVIL-TE-KOSOVES.pdf>

36 Procesi legjislativ i Projektligjit për Zyrarët Publikë, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=437>

37 Ligji për Zyrarët Publikë dërgohet në Gjykatën Kushtetuese, <https://kosovapress.com/ligji-per-zyrtaret-publike-smund-te-hyje-ne-fuqi-deri-ne-vendimin-final-te-gjykates-kushtetuese/>

38 Aktgjykimi nr.ref.:AGJ 2152/23, datë 5 prill 2023, [https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/04/ko\\_100\\_101\\_22\\_agj\\_shq.pdf](https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/04/ko_100_101_22_agj_shq.pdf)

39 Projektligji nr. 08/L-136 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=372>

40 Komisioni i Venecias – Opinion në rastin e rishikuar të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, miratuar nga Komisioni i Venecias në mbledhjen plenare të 130-të, të mbajtur më 18-19 mars 2022, [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2022\)006-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2022)006-e)

41 Projektligj për Investime të Qëndrueshme, <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/01/Projektligj-per-Investime-te-Qendrueshme.pdf>



Edhe pas miratimit të Ligjit për Pagat, koeficienti i pagës bazë nuk është ditur deri në momentin kur është miratuar Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 më 2 shkurt 2023.<sup>42</sup> Pra, projektligj, i cili nuk ka kaluar në konsultime publike. Ndërsa, Ligji për pagat në sektorin publik është publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 5 janar 2023.<sup>43</sup>

Sa i përket nënkategorisë Pritjet legjitime, e cila ka të bëjë me faktin se sa autoritetet publike ju përbahen premtimeve dhe pritjeve të ngritura dhe jo vetëm nga ligji. Në këtë rast, në vitin e fundit autoritetet publike kanë dështuar të respektojnë parimin e pritjes legjitime. Gjatë periudhës së vlerësimit, ka ndodhur që Gjykata Kushtetuese të shfuqizojë në tërësi një ligj të caktuar për shkak të mospërputhjes me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ligji për zyrtarët publik është në kundërshtim me pritjet legjitime të tyre për faktin se ndërprehet marrëdhënia e rregullt e punës në shërbimin civil në mënyrë arbitrare dhe ex lege në kundërshtim me pritjet legjitime të tyre. Pra, përkundërfaktit që pritjet kanë qenë që Kushtetuta dhe ligji të respektohen. Për sa i përket premtimeve, gjithashtu në këtë drejtim duhet të punohet më shumë për shkak që nuk kanë arritur që t'ju përmbahen.

Ndërsa, nënkategoria Retroaktivitetit të legjislacionit, vlen të theksohet se nuk ka ndonjë ligj të përgjithshëm që flet për retroaktivitetin e ligjeve. Mirëpo, Kodi Penal i Republikës së Kosovës e ndalon shprehimisht retroaktivitetin e ligjit në çështje penale.<sup>44</sup> Nullum Crimen Sine lege dhe Nulla poena sine lege zbatohen si parime ligjore dhe janë të parashikuara në Kodin Penal si dhe në Kushtetutë. Parimin Res Judicata e parashikon Kodi Penal i Kosovës.

Rezultati përfundimtar i Sigurisë juridike është 8.5 nga gjithsej 16 pikë (53.12 %), ngjashëm me vlerësimin e kaluar. Është e nevojshme që të punohet më shumë në drejtim të parashikueshmërisë së ligjeve, në procedurën e konsolidimit të ligjeve, e sidomos në drejtim të stabilitetit dhe konsistencës së ligjeve, duke mundësuar një stabilitet më të madh ligjor dhe pa ndryshime të shpeshta e të paparashikueshme.

### C. PARANDALIMI I ABUZIMIT (KEQPËRDORIMIT) TË PUSHTETIT

Parandalimi i abuzimit (keqpërdorimit) të pushtetit përfshin vetëm një nënkategori, e cila është ekzistenca e garancive ligjore kundër arbitraritetit dhe abuzimit të pushtetit nga autoritetet publike. Në Kosovë ekziston legjislacioni në këtë drejtim. Megjithatë, mungon zbatimi apo funksionimi adekuat i mekanizmave për të parandaluar, korrigjuar dhe sanksionuar këto veprime arbitrare. Kjo nënkategori trajton përveç tjerash edhe faktin se autoritetet publike a janë të detyruara të paraqesin arsyetim adekuat për vendimet e tyre, e sidomos kur i prek të drejtat e nje individi.

Në vitet e fundit ka pasur shumë raste të keqpërdorimit, si nga Presidenti, Kryeministri dhe zyrtarë të tjerë. Gjatë periudhës vlerësuese, Ministria e Shëndetësisë, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore kishte hapur process rekrutues për drejtor të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore në Kosovë në kundërshtim me ligjin, me kërkesat e përgjithshme formale për nivelin e arsimit të kërkuar., si dhe zvogëlimi i përvojës së punës.<sup>45</sup> Fillimisht këto gjetje totalisht injorohen ndërsa në fund të kalimit të afatit të konkursit, konkursi anulohet nga Fondi i Sigurimeve Shëndetësore.<sup>46</sup>

Duhet theksuar se mos emërimi i Kryeprokurorit të shtetit ose moskthimi i përgjigjes për mos emërim është një formë e keqpërdorimit të pushtetit. Presidentja e Republikës së Kosovës më 7 prill 2023 ka reaguar duke thënë që Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) po ushtron "presion të papranueshëm dhe të paligjshëm" lidhur me procesin e emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit, për arsye se KPK kishte kërkuar që me urgjencë ta dekretonte Kryeprokurorin e Shtetit.<sup>47</sup> Osmani ka deklaruar se do të pres shterimin

42 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, publikuar në faqen e Zyrës së Kryeministrit më 2 shkurt 2023, <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/projektligj-per-ndryshimin-dhe-plotesimin-e-ligjit-nr-08-l-193-mbi-ndarjet-buxhetore-per-buxhetin-e-republikes-se-kosoves-per-vitin-2023/>

43 Ligji nr. 08/L-196 për pagat në sektorin publik, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=68695>

44 Kodi nr. 06/L-074 penal i Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18413>

45 Kërkohe anulimit i konkursit për drejtorin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, shkak parregullsitë, [https://www.koha.net/arberi/366574/kerkohet-anulimi-i-konkursit-per-drejtorin-e-fondit-te-sigurimeve-shendetesore-shkak-parr-regullsite/?fbclid=IwAR1BLjioaLYHLbLDVC1SZQHEXG7T5sDhJT9Xiwl2WTCWmXZ5aSc\\_PA2BNYg](https://www.koha.net/arberi/366574/kerkohet-anulimi-i-konkursit-per-drejtorin-e-fondit-te-sigurimeve-shendetesore-shkak-parr-regullsite/?fbclid=IwAR1BLjioaLYHLbLDVC1SZQHEXG7T5sDhJT9Xiwl2WTCWmXZ5aSc_PA2BNYg)

46 Vendim për anulimin e konkursit, datë 21 mars 2023, <https://fssh.rks-gov.net/desk/inc/media/AEFA382-3821-46C0-B0BD-387C81C48069.pdf>

47 Osmani i përgjigjet KPK-së për kryeprokurorin, e akuzon për presion të paligjshëm,

e afateve ligjore e kushtetuese, deri kur kandidatët mund t'i adresojnë pretendimet e tyre lidhur me procesin. Megjithatë, të gjitha afatet ligjore kanë përfunduar, si dhe Gjykata Supreme ka refuzuar ankesën e kundërkandidatit për procesin e Kryeprokurorit të Shtetit. Gjykata Supreme e ka hedhur poshtë ankesën duke vërtetuar aktvendimin e Gjykatës së Apelit dhe atë të Themelores, të cilat kanë gjetur se padia e paditësit është e pasafatshme.<sup>48</sup>

Një keqpërdorim tjetër i pushtetit është miratimi i akteve ligjore dhe nënligjore pa i respektuar procedurat ligjberëse të vendit. Në këtë rast nxjerrja e akteve nënligjore që burojnë nga Ligji nr. 08/L-196 për Pagat në sektorin publik ka qenë një shkelje e rëndë, për arsye se asnjëra nga to nuk është konsultuar me publikun. Në shkurt të vitit 2023 këto akte janë miratuar dhe publiku është njoftuar vetëm pas publikimit në Gazetën Zyrtare.<sup>49</sup>

Nga kjo që u tha më lartë, rezultati i përgjithshëm për këtë kategori është 1.5 pikë nga gjithsej 4 pikë (37,5% e përbushjes).

#### *D. BARAZIA PARA LIGJIT DHE MOSDISKRIMINIMI*

Kategoria Barazia para ligjit dhe mosdiskriminimi është kategoria e katërt e Listës së Kontrollit të Sundimit të Ligjit. Në këtë drejtim, Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 24 përcakton se të gjithë janë të barabartë para ligjit e po ashtu siguron mosdiskriminim.<sup>50</sup> Po ashtu, edhe Ligji nr. 05/L-021 për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon shprehimisht diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë.<sup>51</sup>

Megjithatë, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi është vlerësuar si pak i zbatueshëm në praktikë. Më 14 shkurt 2023, Avokati i Popullit para Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione ka thënë se Ligji nuk zbatohet aspak dhe se nuk ka informacione e as nuk është shqiptuar ndonjë gjobë për këtë rast.<sup>52</sup> Avokati i Popullit deklaroi se vetë fushëveprimi i ligjit është i paqartë, ku është vërejtur se ka shumë dilema nga autoritete, të cilat duhet ta zbatojnë ligjin.<sup>53</sup> Në këtë drejtim, Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit ka deklaruar se në gjysmën e parë të vitit 2023 do të bëhet vlerësimi ex-post, ku do të dilet me rekomandime.

Për më tepër, Institucioni i Avokatit të Popullit me datë 7 prill 2023 ka dërguar në Gjykatë Kushtetuese Ligjin nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë së tij me Kushtetutën. Kjo për arsye se ka pranuar 104 ankesa nga subjekte të ndryshme të sektorit publik, të cilat kryesisht kanë pasur të bëjnë me uljen e koeficientit, heqjen e shtesave dhe trajtimin jo të barabartë ndërmjet pozitave të përcaktuara me ligj.<sup>54</sup> Pra, mund të themi se një numër shumë i lartë i zyrtarëve ka reaguar për arsye se konsideron se është diskriminuar nga vetë ligji duke mos marrë trajtim të barabartë për punën, të cilën ata e bëjnë. Gjithashtu, Avokati i Popullit në komunikatën e tij për media ka deklaruar se: "Ligji i kontestuar ka krijuar një situatë divergjente, ku të gjithë të punësuarit nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë as me rastin e uljes dhe as me rastin e ngritjes së pagave. Avokati i Popullit vlerëson se ulja dhe rritja e pagave duket se nuk janë bazuar në një vlerësim të mirëfilltë paraprak dhe as në një sistem linear, madje as përbrenda sektorëve të caktuar, që ka rezultuar që disa punonjës të pësonin ulje, e disa të tjerë rritje të pagave, madje edhe përbrenda së njëjtës organizatë."

Në këtë drejtim, nënkategoria Barazia në ligj dhe Barazia para ligjit, edhe pse Kosova vazhdon të jetë mirë, meqenëse ekziston legjislacioni që garanton barazinë në ligj, ka probleme të vazhdueshme në zbatim. Kosova është një shtet multi etnik, ku Kushtetuta u njeh të drejta të veçanta, krahas të drejtave

<https://www.koha.net/arberi/372734/osmani-i-pergjigjet-kpk-se-per-kryeprokurorin-e-akuzon-per-presion-te-paligjshem/>

48 Supremja refuzon ankesën e Shqipdon Fazliut për procesin e Kryeprokurorit të Shtetit,

<https://kallxo.com/uncategorized/supremja-refuzon-ankesen-e-shqipdon-fazliut-per-procesin-e-kryeprokurorit-te-shtetit/>

49 Aktet nënligjore të Ligjit nr. 08/L-196 për pagat në sektorin publik, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=68695>

50 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 24 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>

51 Ligji nr. 05/L-021 për mbrojtjen nga diskriminimi, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10924>

52 Qelaj: Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi s'prodhoi rezultate, askush nuk u dënua për këtë, <https://ekonomiaonline.com/qelaj-ligji-per-mbrojtjen-nga-diskriminimi-sprodhoi-rezultate-askush-nuk-u-denua-per-kete/>

53 Po aty.

54 Komunikatë për media – Avokati i Popullit dërgoi në Gjykatën Kushtetuese Ligjin nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë së tij me Kushtetutën, <https://oik-rks.org/2023/04/07/komunikate-per-media-avokati-i-popullit-dergoi-ne-gjykatën-kushtetuese-ligjin-nr-08-l-196-per-pagat-ne-sektorin-publik-me-kerkese-per-vlerësimin-e-perputhshmerise-se-tij-me-kushtetuten/>



dhe lirive themelore të njeriut, banorëve që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës. Gjatë kësaj periudhe ka pasur një lëvizje pozitive, ku është aprovuar kërkesa e vazhdueshme e komunitetit rom për njohje të gjuhës rome si gjuhë zyrtare në Komunën e Prizrenit. Gjuha rome nga nëntori i vitit 2022 është njohur si gjuhë në përdorim zyrtar në Komunën e Prizrenit, ku Kuvendi i Komunës së Prizrenit kishte votuar pro njohjes së gjuhës rome.<sup>55</sup> Ndërsa, 1 marsi, Dita Ndërkombëtare e Përdoruesve të Karrocës u shënuar në Kosovë përmes solidarizimit të përfaqësuesve të institucioneve duke u ulur në karrocë duke pasur për qëllim që të ngritet vetëdija institucionale dhe shoqërore për krijim të mundësive të barabarta në qasje infrastrukturore, përfshirë në institucione të larta shtetërore, si dhe për veprim në përmirësimin e kushteve në çdo fushë të jetës së përditshme për komunitetin.<sup>56</sup> Gjithashtu, vlen të theksohet, se ka pasur reagime të shumta për rivlerësimin e personave me aftësi të kufizuar për arsye se pavarësisht dokumenteve mjekësore ju është mohuar e drejta në kompensim sipas atij vlerësimi.<sup>57</sup>

Kjo kategori shënoi 7 pikë nga gjithësej 10 pikë (70%), që do të thotë se nuk ka pasur ndryshim nga vlerësimi i kaluar.

## E. QASJA NË DREJTËSI

Qasja në Drejtësi përfshin tre nënkategori të ndryshme: Pavarësinë dhe Paanshmërinë, Gjykimin e Drejtë dhe Drejtësinë Kushtetuese. Këto parime janë të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në Kapitullin VII, Sistemi i Drejtësisë, ku gjithashtu garantohet një pushtet gjyqësor unik, i pavarur, i drejtë, apolitik dhe i paanshëm, si dhe sigurohet qasje e barabartë në Gjykata.

Nënkategoria e parë është Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit. Kjo nënkategori shënoi 9 pikë nga 14 gjithsej (64,28%), e cila përfshin pavarësinë e gjyqësorit duke vlerësuar se a ekzistojnë garancitë kushtetuese dhe ligjore për pavarësinë e gjyqësorit. Pavarësia e gjyqësorit përcaktohet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe po ashtu në ligje të veçanta. Kriteret dhe procedura për emërimin e gjyqtarëve janë të përcaktuara në detaje me Ligjin për Gjykatat.<sup>58</sup> Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjyqtarët mund të shkarkohen vetëm në rastet kur dënohet për një vepër të rëndë penale ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave. Më në detaje këtë çështje e rregullon Rregullorja për procedurën disiplinore të gjyqtarëve nr. 05/2019,<sup>59</sup> e cila e rregullon procedurën disiplinore që zhvillohet para Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin në vijim: Këshilli). Këshilli themelon panelin hetimor, ku për shqyrtimin e një rasti disiplinor ky panel përbëhet nga tre (3) gjyqtarë, të cilët nuk shërbejnë në Gjykatën ku shërben gjyqtari ndaj të cilit zhvillohet procedura. Pra, përbërja e panelit hetimor përbëhet vetëm nga gjyqtarë të shkallëve të ndryshme. Sa i përket transferimit të gjyqtarëve Kushtetuta parasheh që: "gjyqtarët nuk mund të transferohen kundër vullnetit të tyre, përveç nëse është parashikuar ndryshe me ligj, për shkak të funksionimit efikas të gjyqësorit ose masave disiplinore".<sup>60</sup> Më në detaje çështja e transferimit rregullohet me Rregulloren nr. 08/2022 për transferimin e gjyqtarëve.<sup>61</sup> Kjo rregullore përcakton rregullat e transferimit të rregullt, të jashtëzakonshëm dhe të përhershëm. Gjyqtari, po ashtu ka të drejtë në ankesë kundër vendimit për transferim, në Gjykatën Supreme përmes Këshillit. Gjatë kësaj periudhe, ka vazhduar puna për vettingun në Kosovë, ku pas miratimit të Koncept Dokumentit është hartuar propozimi për amandamentet kushtetuese për proces të vettingut. Komisioni Ad-hoc për Zhvillimin e Procesit të Vlerësimit Kalimtar është takuar me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me progresin në hartimin e Projektligjit për Kontrollin e Integritetit të Pozitave të caktuara në Sistemin e Drejtësisë dhe për amandamentet kushtetuese. Gjykata Kushtetuese ka pranuar projekt

55 Gjuha rome njohet si gjuhë zyrtare në përdorim zyrtar në Komunën e Prizrenit, <https://kallxo.com/lajm/gjuha-rome-njihet-si-gjuhe-ne-perdorim-zyrtar-ne-komunen-e-prizrenit/>

56 Krerët institucionale solidarizohen duke u ulur në karrocë për 1 Mars – Qasja, sfidë kryesore, <https://handi-kos.org/kreret-institucionale-solidarizohen-duke-u-ulur-ne-karroce-per-1-mars-qasja-sfide-kryesore/>

57 Personat me aftësi të kufizuar kritikojnë komisionin vlerësues mjekësor, <https://teve1.info/lajmet/personat-me-aftesi-te-kufizuar-kritikojne-komisionin-vleresues-mjekesor/>

58 Ligji nr. 06/L-054 për Gjykatat, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302>

59 Rregullore (05/2019) për procedurën disiplinore të gjyqtarëve, [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/6651\\_Rregullorja%2005-2019.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/6651_Rregullorja%2005-2019.pdf)

60 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 104, paragrafi 6, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

61 Rregullore nr. 08/2022 për transferimin e gjyqtarëve, [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/57309\\_KGJK\\_Rregullore\\_Nr\\_08\\_2022\\_transferimin\\_brendshem\\_gjyqtareve.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/57309_KGJK_Rregullore_Nr_08_2022_transferimin_brendshem_gjyqtareve.pdf)

amandamentet kushtetuese për vlerësim të kushtetutshmërisë.<sup>62</sup> Më 2 mars 2023, Kryetari i Kuvendit të Kosovës ka njoftuar se i ka përcjellur në Gjykatën Kushtetuese amandamentet kushtetuese lidhur me Vettingun në sistemin e drejtësisë.<sup>63</sup>

Sa i përket Pavarësisë së gjyqtarëve individual shënoi 2 pikë nga 4 gjithsej. Secila Gjykatë ka Kryetarin dhe nënkryetarin, e cila përcaktohet me Ligjin për Gjykatat.<sup>64</sup> Neni 14 i këtij ligji përcakton në detale kompetencat e Kryetarit dhe të nënkryetarit të Gjykatës, ku ndër të tjera Kryetari i Gjykatës është përgjegjës për organizimin dhe bashkërendimin në funksionimin e Gjykatës. Ndërsa, sa i përket konfliktit të kompetencave ndërmjet Gjykatave, Ligji për Gjykatat i jep kompetencë Gjykatës së Apelit që të vendos në rastet e konfliktit të juridiksionit ndërmjet gjykatave Themelore.<sup>65</sup>

Ndërsa, Paanshmëria e gjyqësorit, edhe pse nuk ka pasur vlerësim të fundit për perceptimin qytetar mund të themi se nuk ka pasur ndryshime. Shumë raste të lirimeve të të akuzuarve apo dënimeve minimale sidomos në rastet e dhunës ndaj gruas kanë ngjallur reagime të shumta nga qytetarët. Andaj, shënoi 0 pikë nga gjithsej 2 pikë.

Një çështje tjetër është Autonomia dhe kontrolli i prokurorisë, e cila shënoi 4 pikë nga 12 pikë gjithsej duke shënuar rënie nga vlerësimi i kaluar. Gjatë kësaj periudhe, Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës është miratuar në Kuvend, mirëpo i njëjti është dërguar për vlerësim të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese. Ndryshimet kryesore që parashihen të bëhen me këtë Ligj janë përbërja e Këshillit Prokurorial të Kosovës, duke e zvogëluar numrin e anëtarëve dhe përfshirja e anëtarëve, të cilët nuk janë prokurorë, si dhe ndërprerja e menjëhershme e mandatit të anëtarëve aktual të Këshillit Prokurorial. Vlen të theksohet se projektligji është dërguar edhe në Komisionin e Venecias, ku ky i fundit ka lëshuar opinion e dytë ligjor më 23 mars të vitit 2022 mbi draftin e rishikuar.<sup>66</sup> Këto ndryshime ligjore, sipas Ministrisë së Drejtësisë, si propozues të këtij Projektligji kanë për qëllim që t'i adresojnë problemet e mëparshme duke reformuar Këshillin Prokurorial të Kosovës. Komisioni i Venecias në opinionin e tij ka theksuar se përfshirja e të zgjedhurve nga ana e Kuvendit të Kosovës si anëtarë të Këshillit Prokurorial nuk është kundër standardve Evropiane si e tillë, mirëpo duhet pasur kujdes që prezenca e tyre të mos dërgojë në politizimin e Këshillit.<sup>67</sup> Gjykata Kushtetuese përmes Aktgjykimit të saj ka shpallur të pavlefshëm në tërësi këtë Ligj. Miratimi i një Ligji, i cili bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës është dështim i institucioneve përgjegjëse, pra përkundër faktit që drafti i ligjit është dërguar për vlerësim në Komisionin e Venecias, nuk ka arritur t'i përmbahet këtyre gjetjeve. Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese ka konstatuar se Ligji i kontestuar nuk është në përputhje Kushtetutën e Republikës së Kosovës, specifikisht me nenet Forma e qeverisjes dhe ndarjes së pushtetit, me kompetencat e Kuvendit, Roli dhe kompetencat e Avokatit të Popullit, Këshilli Prokurorial i Kosovës, po ashtu me nenet për Barazinë para Ligjit, të drejtën në mjete juridike dhe mbrojtjen gjyqësore të të drejtave.<sup>68</sup> Sipas edicionit të fundit të Drejtësia Sot<sup>69</sup>, vetëm 15,9% e të anketuarve mendojnë se prokuroria është në gjendje të kryejë detyra/përgjegjësi në mënyrë të pavarur, prandaj është konsideruar se ende duhet punë për të pasur një perceptim pozitiv.<sup>70</sup>

Sa i përket, Paanshmërisë dhe pavarësisë së Avokaturës shënoi 4.5 pikë nga totali prej 5 pikëve. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 111 e definon Avokaturën si profesion të pavarur, e cila ofron shërbime në përputhje me ligjin.<sup>71</sup> Në Kosovë ekziston një trup i pavarur dhe i organizuar për profesionin e Avokatisë. Ligji nr. 04/L-193 për Avokatinë rregullon, ndër të tjera organizimin dhe punën

62 Komisioni ad-hoc formon Grupin Punues për shqyrtimin e Projektligjit për Vettingun, <https://ekonomiaonline.com/komisioni-ad-hoc-formon-grupin-punues-per-shqyrtimin-e-projektligjit-per-vettingun/>

63 Po aty.

64 Ligji për Gjykatat, neni 14, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302>

65 Ligji për Gjykatat, neni 22, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302>

66 Kosovë – Opinioni mbi draftin e reviduar të ndryshimeve të Ligjit për Këshillin Prokurorial, të miratuar nga Komisioni i Venecias në mbledhjen plenare të 130-të, [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2022\)006-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2022)006-e)

67 Ibid.

68 Aktgjykim në rastet nr. KO100/22 dhe KO101/22 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, [https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/04/ko\\_100\\_101\\_22\\_agj\\_shq.pdf](https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/04/ko_100_101_22_agj_shq.pdf)

69 Drejtësia Sot është produkt i zhvilluar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) nën mbështetjen e Ambasadës Britanike në Kosovë, që përfaqëson një sistem të monitorimit mbi sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

70 Raport Monitorimi: Monitorimi i Sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë, publikuar mars 2022, <https://www.rolpik.org/wp-content/uploads/2022/04/Raporti-vjetor-i-monitorimit-Janar-Dhjetor-2021-shqip-1.pdf>

71 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 111, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>

e Odës së Avokatëve të Kosovës.<sup>72</sup> Në këtë ligj përcaktohet se mbikëqyrja e ligjshmërisë së akteve të përgjithshme të Odës së Avokatëve bëhet nga Qeveria e Kosovës, ndërsa përcjelljen e punës së avokatisë dhe kushtet për punën e saj e bënë Ministria e Drejtësisë duke pasur kujdes për pavarësinë e saj. Megjithatë, nuk ka të dhëna publike se si funksionon mbikëqyrja e Ministrisë së Drejtësisë. Më 21 mars 2023 është raportuar një incident në Odën e Avokatëve të Kosovës, ku një anëtar është shoqëruar në Polici. Ky incident ka ndodhur në mes të dy anëtarëve të këshillit drejtues – kryetarit të degës regjionale të Prishtinës dhe kryetarit të degës regjionale të Gjakovës, ku ka pasur tentim për sulm fizik dhe njëri nga anëtarët është përcjellur në Polici.<sup>73</sup> Një pikë pozitive është që mbledhjet e Këshillit Drejtues të Odës së Avokatëve të Kosovës transmetohen online në faqen e tyre të rrjetit social Facebook. Po ashtu, ka pasur disa raste të mashtrimeve në emër të avokatëve, të cilat janë publikuar në muajin mars 2023. Ka pasur rast kur një ish-avokat i dënuar me burg ka mashtruar qytetarët duke u paraqitur si avokat, përkundër faktit që nuk ka pasur licencë.<sup>74</sup> Oda e Avokatëve të Kosovës ende nuk ka reaguar për të zgjidhur këtë problematikë.

Nënkatëgoria tjetër, Gjykimet e drejta përfshin disa çështje. Kjo nënkategori trajton Qasje në drejtësi. Secili individ ka të drejtë që të kundërshtojë ndonjë akt publik apo privat që cenon të drejtat e tij/saj, sipas legjislacionit në fuqi. Mirëpo, tejzgjatja e zgjidhjes së lëndëve nëpër Gjykata ndikon negativisht në qasje në drejtësi të qytetarëve. Agjencia për ndihmë juridike falas ofron ndihmë juridike falas për individët të cilët nuk kanë mundësi financiare të angazhojnë ndonjë avokat. Sipas Ligjit për Ndhimë Juridike Falas personi që kërkon ndihmë juridike falas duhet t'i plotësojë disa kriteret, si kriteret juridike, financiare dhe kualifikuese.<sup>75</sup> Mirëpo, në rastet urgjente, ndihma juridike falas nga ana e Agjencisë për ndihmë juridike falas mund të jepet pavarësisht përmbushjes së kriterëve të cilat kërkohen me ligj dhe kjo ndihmë jepet menjëherë. Agjencia për ndihmë juridike falas vetëm gjatë muajit shkurt ka ofruar shërbime të ndihmës juridike falas për 535 qytetarë.<sup>76</sup>

Ndërsa, Prezumimi i pafajësisë, përcaktohet me Kodin e Procedurës Penale, në nenin 3 të tij thuhet që çdo person i dyshuar ose që akuzohet për vepër penale konsiderohet i pafajshëm derisa vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës.<sup>77</sup> Megjithatë, shpesh raportimet në media nuk e respektojnë këtë parim dhe ka shumë parregullsi sidomos në raportimet e portaleve të lajmeve në internet. Po ashtu, vlen të theksohet rasti kur Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka pezulluar nga puna drejtorin e Departamentit për Amerikë, përkundër faktit që ai e fitoi rastin në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Më 29 mars 2023 Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka marrë Vendim për pezullimin e marrëdhënies së punës së nëpunësit civil, i cili është pezulluar nga detyra deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga ana e Komisionit Disiplinor. Kjo me arsyetimin se nëpunësi civil pengon hetimin disiplinor dhe cenon ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij.<sup>78</sup> Ndërsa, sa i përket shkarkimit nga pozita të drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent për shkak të dyshimit të bazuar për kryerje të veprës penale,<sup>79</sup> KPMSHCK ka vendosur që të anulohet ky vendim dhe të aprovet ankesa e tij si e bazuar.<sup>80</sup> Në shkurt të vitit 2023 është miratuar Ligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme.<sup>81</sup> Për këtë Projektligj opozita kishte shprehur shqetësimin se hapja e byrosë mund të krijojë institucione paralele të drejtësisë, kështu fillimisht kishte dërguar Projektligjin në Komisionin e Venecias për të kërkuar mendim. Në këtë drejtim, Komisioni i Venecias më datë 20 qershor 2022 ka miratuar opinionin ligjor për këtë çështje. Në këtë opinion është theksuar se edhe pse qëllimi mund të jetë i justifikueshëm duhet pasur parasysh se

72 Ligji nr. 04/L-193 për Avokatinë, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8673>

73 Incident në Odën e Avokatëve të Kosovës, një anëtar shoqërohet në Polici, <https://kallxo.com/lajm/incident-ne-oden-e-avokateve-te-kosoves-nje-anetar-shoqerohet-ne-polici/>

74 Ish-avokati i dënuar me burg mashtron sërish qytetarët, paraqitet si avokat pa licencë <https://betimiperdrejtesi.com/ish-avokati-i-denuar-me-burg-mashtron-serish-qytetaret-paraqitet-si-avokat-pa-licence/?fbclid=IwAR0ETh3hN7WwJLmwqyt-ypNi0zbUXnuAnuYGlNbAOdOeQz7p3-ipGH94dKg>

75 Ligji nr. 04/L-016 për ndihmë juridike falas, neni 6-9, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2803>

76 Ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas gjatë muajit Shkurt 2023, <https://anjf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,2,148>

77 Kodi nr. 08/L-002 i procedurës penale, neni 3, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759>

78 MPJD e pezullon nga puna drejtorin e Departamentit për Amerikë, përkundër që ai e fitoi rastin në Gjykatën Themelore të Prishtinës, <https://www.dukagjini.com/ekskluzive-mpjd-e-pezullon-nga-puna-drejtorin-e-departamentit-per-amerike-perkunder-qe-ai-e-fitoi-rastin-ne-gjykatën-themelore-te-prishtinës-dokument/>

79 Kryeministri Kurti shkarkon Fadil Kodrën (dokument), <https://kallxo.com/lajm/kryeministri-kurti-shkarkon-fadil-kodren-dokument/>

80 Shkarkimet e Kodrës që po i anulon KPMSHCK-ja, <https://kallxo.com/lajm/shkarkimet-e-kodres-qe-po-i-anulon-kpmschck-ja/>

81 Procesi legjislativ i Ligjit nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=359>

konfiskimi civil duhet të dizajnohet dhe zbatohet në përputhje me Kushtetutën e vendit e që zbatohet drejtpërsëdrejti Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut dhe duke i marrë parasysh standardet Evropiane. Në këtë drejtim, Komisioni i Venecias i ka dhënë disa rekomandime për ndryshim të draftit të paraqitur para Komisionit, për arsye se Komisioni ka konsideruar se formulimi i prezentuar mund të paraqet shkelje të të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë.<sup>82</sup> Edhe pas miratimit të ligjit, shqetësimet e opozitës kanë mbetur aktive dhe ky Ligj është dërguar për vlerësim të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese.<sup>83</sup>

Aspektet tjera të së drejtës për gjykim të drejtë janë e drejta për t'u dëgjuar, procedura e ankimit, barazia e armëve, mjetet kundër tejzgjatjes së procedurës gjyqësore, arsyetimi i vendimeve, të cilat po ashtu janë të garantuara edhe me Kodin e ri të Procedurës Penale. Barazia e palëve garantohet me nenin 9 të Kodit të Procedurës Penale. Megjithatë, në praktikë ka raste kur këto parime nuk zbatohen. Së fundi, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar kushtetutshmërinë e "veprimeve dhe mosveprimeve të Gjykatës Themelore në Gjilan, Stacionit Policor në Graçanicë dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë në rastin e cenimit të së drejtës në jetë të nënës së parashtrueses së kërkesës. Gjykata Kushtetuese përmes këtij Aktgjykimi<sup>84</sup> ka vendosur se në rastin në fjalë, Gjykata Themelore në Gjilan, Stacioni Policor në Graçanicë dhe Prokuroria Themelore në Prishtinë kanë dështuar në detyrimin e tyre pozitiv për mbrojtje të jetës, të garantuar me nenin 25, e drejta për jetën, e Kushtetutës, si dhe kanë dështuar në përmbushjen e detyrimeve, reagim, parandalim dhe mbrojtje të menjëhershme, vlerësim të rrezikut dhe menaxhim të rrezikut, si dhe procedimet ex parte dhe ex officio të Konventës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.

Për sa i përket efektivitetit të vendimeve gjyqësore, vlen të theksohet se ato në momentin që janë të plotëfuqishme janë të ekzekutueshme menjëherë. Megjithatë, ka raste kur nuk ndodh mbikëqyrja e zbatimit të vendimeve gjyqësore. Në rastin e padive të parashtruara nga Grupi për Studime Juridike / Qendra për Raste Gjyqësore Strategjike dhe disa organizata për mbrojtjen e ambientit për të kundërshtuar vendimet mjedisore dhe ujore të lëshuara nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për hidrocentralet në Deçan, Shtërpçë dhe Kaçanik, ka raportime që vendimet e gjykatave nuk janë duke u zbatuar.

Nënkategoria e fundit e Qasjes në Drejtësi është Drejtësia Kushtetuese. Kushtetuta është akti më i lartë juridik dhe sipas nenit 16 të Kushtetutës, ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën.<sup>85</sup> Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës duhet ta kenë parasysh çdo herë këtë nen në momentin e draftimit dhe miratimit të akteve juridike. Dështimi i një veprimi të tillë sjellë në jokushtetutshmëri. Kohët e fundit kjo po ndodh shpesh, duke qenë se Gjykata Kushtetuese t'i shfuqizojë ligjet për arsye se përmbajtja e tyre është në kundërshtim me ligjin. Një rast i tillë është Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës ku ky ligj është shpallur i pavlefshëm në tërësinë e tij. Sa i përket individëve, ata kanë qasje në drejtësinë kushtetuese në rastet kur u janë shkelur të drejtat e tyre themelore, pasi t'i kenë shtjerur të gjitha mjetet e tjera juridike. Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk ofron mundësi për "actio popularis", pra individët nuk kanë të drejtë të ndërmarrin veprime për të shqyrtuar kushtetutshmërinë e akteve normative pas hyrjes së tyre në fuqi. Në rastin nr. K1185/21, parashtruesi, individ – biznes, kishte kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-155 për ndalimin e lojërave të fatit dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme ARJ.UZVP.nr.83/2021 të 7 shtatorit 2021. Gjykata Kushtetuese përmes Aktgjykimit të datës 13 mars 2023 ka riktheksuar se personat fizikë ose juridikë nuk janë palë të autorizuar dhe se Gjykata në vazhdimësi ka theksuar se individët nuk mund të kontestojnë akte normative të karakterit të përgjithshëm.<sup>86</sup> Megjithatë, Gjykata

82 Komisioni i Venecias, Opinion nr. 1083/2022 i dt. 20 qershor 2022 mbi Projektligjin nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2022\)014-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2022)014-e)

83 PDK-ja dërgon në Kushtetuese Projektligjin për Byronë, <https://www.koha.net/arberi/366686/pdk-ja-e-dergon-ne-kushtetuese-projektligjin-per-byrone/>

84 Aktgjykim në rastin nr. K1129/21, Vlerësim i kushtetutshmërisë ë "veprimeve dhe mosveprimeve" te Gjykatës

Themelore në Gjilan, Prokurorisë Themelore në Gjilan, Stacionit Policor në Graçanicë dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë, [https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/03/ki\\_129\\_21\\_agj\\_shq.pdf](https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/03/ki_129_21_agj_shq.pdf)

85 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 16, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

86 Aktgjykim nr.Ref.:ACJ 2139/23, datë 13 mars 2023 në rastin nr. K1185/21, parashtrues sh.p.k "CO COLINA" – Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-155 për Ndalimin e Lojërave të Fatit dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme ARJ. UZVP. nr.83/2021 të 7 shtatorit 2021, [https://gjk-ks.org/decision/kerkese-per-vleresimin-e-kushtetutshmerise-se-ligjit-nr-06-l-155-per-ndalimin-e-lojerve-te-fatit-dhe-aktgjykimit-te-gjykatës-supreme-arj-uzvp-nr-83-2021-te-7-shtatorit-2021/?decision\\_view=text](https://gjk-ks.org/decision/kerkese-per-vleresimin-e-kushtetutshmerise-se-ligjit-nr-06-l-155-per-ndalimin-e-lojerve-te-fatit-dhe-aktgjykimit-te-gjykatës-supreme-arj-uzvp-nr-83-2021-te-7-shtatorit-2021/?decision_view=text)

ka theksuar se e vetmja mënyrë që individët të kontestojnë një ligj është ku "arrijnë të dëshmojnë se ata janë prekur nga një "ligj" në mënyrë të drejtpërdrejtë, në mungesë të ndonjë akti, vendimi ose mase që zbaton atë ligj dhe nëse i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, kur të njëjtat ekzistojnë në dritë të rrethanave të një rasti konkret."<sup>87</sup> Por, individët kanë qasje në drejtësinë kushtetuese në rastet kur u janë shkelur të drejtat e tyre themelore, pasi t'i kenë shteruar të gjitha mjetet e tjera juridike.

Vlen të theksohet, se ka pasur raste kur Ekzekutivi nuk ka marrë për bazë në tërësi vlerësimet e Gjykatës Kushtetuese, që mund ta vërejmë në rastin e Ligjit për Zyrarët Publikë dhe Ligjit për Pagat, të cilat versionet e reja janë miratuar pa u përmbajtur gjetjeve të Gjykatës Kushtetuese.<sup>88</sup> Kjo ka bërë që këto dy ligje të dërgohen përsëri për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese, duke e zgjatur edhe më shumë reformën në administratën publike. Vlen të theksohet, se pas aktgjyimit të Gjykatës Kushtetuese për Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ministria e Ministrisë së Drejtësisë në konferencë për media deklaroi se: "Është absurde se si Kushtetuesja e gjeti si ndikim të politikës, që në KPK të jetë një anëtar nga Avokati i Popullit, derisa Komisioni i Venecias këtë e ka konsideruar në raport me standardet ndërkombëtare. Pse Gjykatës Kushtetuese ju deshën 9 muaj për të nxjerrë këtë Aktgjykim. Pse në morën 9 muaj? Pse iu nevojitën kaq shumë kohë?"<sup>89</sup> Kjo nënkategori shënoi 4 pikë nga gjithsej 7.

Qasja në Drejtësi shënoi 39 pikë nga gjithsej 67 pikë, që do të thotë se shënoi 58.2%. Nga kjo rrjedh që nuk ka pasur shumë ndryshime nga vlerësimi i kaluar dhe se duhet të punohet më shumë në përmirësimin e qasjes në drejtësi dhe në këtë mënyrë në ndryshimin e perceptimit publik dhe rritjen e besimit të tyre në drejtësi.

## Përfundimet

Sektori i Sundimit të Ligjit në Kosovë është duke u përballur me sfida të shumta. Në këtë periudhë është duke u kaluar nëpër reforma të shumta ligjore, të cilat shpesh përballen edhe me vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese për kushtetutshmëri. Ka pasur raste kur Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se ligji i miratuar ka qenë në kundërshtim me Kushtetutën duke i paraqitur të gjeturat e saj. Një problem tjetër është se kanë filluar që procedurat ligjbërëse të mos respektohen duke anashkaluar në tërësi procesin e konsultimeve. Gjithashtu, mbetet sfiduese zbatimi i legjislativës në praktikë, ku nevojitet një fokus më i madh i institucioneve përgjegjëse që të zgjidhet kjo problematikë. Vlerësimi për periudhën nëntor 2022 – prill 2023 nuk paraqiti ndonjë ndryshim të madh me vlerësimin e kaluar, megjithatë shënoi një rënie të lehtë të pikëve. Qeveria e Kosovës duhet të ndërmerr veprime për të rritur besimin e qytetarëve në institucionet e sundimit të ligjit, të bëhen më shumë përpjekje për të siguruar transparencë, sidomos gjatë propozimeve të reja legjislative, llogaridhënie dhe paanshmëri të sektorit të drejtësisë. Në të njëjtën kohë, sektori i drejtësisë dhe niveli institucional duhet të angazhohen më tej për të marrë parasysh standardet ndërkombëtare, si ato të listës së kontrollit të Komisionit të Venecias, në mënyrë që Kosova të vazhdojë më tutje rrugëtimin e saj në procesin e integritetit në Bashkimin Evropian.

Pjesa në vazhdim ofron disa rekomandime bazuar në sfidat, mangësitë dhe problemet e identifikuara gjatë kësaj periudhe të vlerësimit.

<sup>87</sup> Po aty.

<sup>88</sup> Projektligji nr. 08/L-197 për zyrarët publik, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=437>  
Ligji nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=68695>


<sup>89</sup> Haxhiu për ligjin për Këshillin Prokurorial: Kushtetuesja e goditi reformën në drejtësi, <https://www.dukagjini.com/haxhiu-per-ligjin-per-keshillin-prokurorial-kushtetuesja-e-goditi-reformen-ne-drejttesi/>

## *Rekomandimet:*

- Institucionet publike duhet të sigurojnë gjithmonë konsistencë në mes të ligjeve, përfshirë edhe aktet nënligjore me Kushtetutën;
- Institucionet publike duhet të sigurojnë zbatimin e ligjeve në tërësi dhe për moszbatuesit të ndërmerren masa të caktuara;
- Institucionet publike duhet t'i respektojnë të gjitha procedurat ligjëbërëse të përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
- Institucionet publike duhet të sigurojnë miratimin e ligjeve pa vonesë, kur kërkohet nga Gjykata Kushtetuese;
- Rregullimi i çështjes së versioneve të konsoliduara të ligjit, duke qenë se është një nevojë urgjente;
- Rregullimi i procesit të vlerësimit ex-post të legjislacionit, duke mundësuar publikimin e raporteve të tilla në mënyrë që të jenë lehtësisht të qasshme për publikun;
- Është thelbësore që Komisioni Parlamentar për Legjislacion të përmirësojë rolin e tij mbikëqyrës siç është mandatuar me ligj;
- Institucionet publike duhet të lehtësojnë qasjen në drejtësi për grupet e marginalizuara dhe të sigurojnë zbatimin e ligjit të mosdiskriminimit. Përveç kësaj, ato duhet të ofrojnë masa pozitive në dobi të grupeve të veçanta në mënyrë që të adresojnë pabarazitë ekzistuese;
- Ndihma juridike duhet të jetë e disponueshme për çdo individ, së bashku me ndihmën juridike pro-bono për ata që kanë vështirësi financiare;
- Të nxitet Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) për transparencë dhe llogaridhënie;
- Institucionet publike duhet t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që vendimet e gjykatës të zbatohet në plotëni;
- Institucionet publike përgjegjëse të njihen me listën e Kontrollit të Komisionit të Venecias dhe të bëhet një vlerësim i sundimit të ligjit duke u bazuar në këtë dokument.




Lista kontrolluese për Studimin e Ligjit  
*Gjetjet nëntor 2022 – prill 2023*



Lista Kontrolluese Krahasuese  
*2021/2022*

■ Maj - tetor 2021  
■ Nëntor 2021 - prill 2022  
■ Maj - tetor 2022







GRUPI PËR STUDIME  
JURIDIKE DHE  
POLITIKE

# Grupi për studime jurike dhe politike

është një organizatë e pavarur, jopartiake dhe jofitimprurëse e politikave publike me qendër në Prishtinë, Kosovë.

Misioni ynë është që të zhvillojmë hulumtime të besueshme në fushën e politikës, ligjit dhe ekonomisë dhe të shtyjme përpara zgjidhjet e politikave që adresojnë dështimet dhe/ ose trajtojnë problemet në fushat e politikave të lartpërmendura.



GRUPI PËR STUDIME  
JURIDIKE DHE  
POLITIKE



Embassy of the  
Kingdom of the Netherlands